



Pranimar / Dorezuar Prilipenol/Prudato Received/Delivety	13.04.2021	1	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Prileq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM84CK	1746/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.186/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2604/19 të datës 25.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.491/2019 të datës 23.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga “Mehmet Akif Ersoy”, Nr.77, në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr. KZKA–10/2019, të datës 29.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.491/2019 e datës 23.08.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. **MBETET në fuqi** Vendimi me Nr. KZKA–10/2019, i datës 29.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 28.05.2019 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për autorizimin e shpalljes së konkursit për pozitën: “Zyrtar për Planifikim Hapësinor”.

Pas marrjes së miratimit nga MAP/DASHC, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datë 31.05.2019 deri me 14.06.2019, ka publikuar konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës “Zyrtar për Planifikim Hapësinor”.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur të datës 31.05.2019 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për vendin e punës “Zyrtar për Planifikim Hapësinor”, dhe e njëjta është përfshirë në listën e ngushtë dhe ka marr pjesë në testin me shkrim dhe në intervistë.

Ankuesja e pakënaqur me rekomandimin e komisionit përzgjedhës të datës 28.06.2019, me datë 15.07.2019, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 29.07.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. KZKA – 10/2019, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit Nr. KZKA–10/2019 të datës 29.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më datë 23.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3813/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ankuesja me datë 29.08.2019 ka bërë plotësimin e ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 27.08.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa me datë 30.08.2019 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3813/2019 të datës 23.08.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimi i ankesës i datës 29.08.2019; Emali i datës 03.08.2019; Vendimin Nr. KZKA – 10/2019 të datës 29.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Kërkesa për përgjigje e datës 27.08.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 30.08.2019; Ankesa e datës 15.07.2019 drejtuar KZKA-së; Emali zyrtar i datës 04.07.2019; Njoftimi për përfundimin e procedurës së rekrutimit dhe rezultatin e testimit; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 04.07.2019; vendimi i datës 04.07.2019; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 28.06.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidateve; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe te huaj; Përcaktimi i kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe te huaj; Testi me shkrim i datës 26.06.2019; Emali zyrtar i datës 25.07.2019; Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë; Raporti mbi selektimin e kandidatëve i datës 21.06.2019; Përcaktimi i kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 21.06.2019; Vendimi për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës i datës 19.06.2019; Regjistri i aplikacioneve; Konkursi i datës 31.05.2019 i publikuar në gazetën ditore “Bota Sot”; Kërkesa për punësim e kandidates me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesa për punësim e kandidates me dokumentet e bashkangjitura; Aktgjykimin A.nr.2604/19 të datës 25.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Komisioni Përzgjedhës ka bërë shkelje në përzgjedhjen e kandidateve të suksesshëm, ka konstatuar se kriteret e konkursit për këtë pozitë kanë qenë: **“Diplomë universitare nga fakulteti i Arkitekturës; Minimumi dy (2) vite provojë pune profesionale”**, andaj në bazë të kritereve të konkursit Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka bërë vlerësimin e aplikacioneve duke u bazuar në dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës dhe elementet e tjera të meritës”**. Kolegji për shqyrtimin e

ankesave, pas shqyrtimit të gjitha dëshmimeve për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatës së përzgjedhura dhe të ankueses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të suksesshme për pozitën “Zyrtar për Planifikim Hapësinor”, duke vepruar në përputhje me nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: **“Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes...”**, dhe se kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se kandidatja e përzgjedhur Arbërore Veliu i ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas konkursit të datës 31.05.2019 të shpallur nga MMPH për pozitën “Zyrtar për Planifikim Hapësinor”. Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga provat e lëndës ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur, Arbërore Veliu në bazë të dokumentacionit posedon Diplomën me Nr.273 të datës 14.02.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se më datë 12.01.2005 ka përfunduar Fakultetin Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Dega e Arkitekturës, duke marrë titullin “Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës”, si dhe me përvojë të punës: nga data 01.03.2016 deri me 09.10.2018 në “Arti Group”, në pozitën “Arkitekthe – Menaxhere e Projektit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Planifikim Hapësinor” në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është zhvilluar konform nenit 11 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”**, si dhe nenit 18 paragrafit 1 të këtij ligji i cili përcakton se: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”** dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Kolegji konstaton se kandidatja e suksesshme për pozitën “Zyrtar për Planifikim Hapësinor” i ka plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs dhe se pretendimi i ankueses se ajo nuk e plotëson provojnë e punës pas datës së diplomimit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cili pretendon se pasi që e ka parë testin me shkrim ka vërejtur se i janë ulur pikët edhe pse përgjigjet kanë qenë të sakta, ka konstatuar se nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi me rastin e vlerësimit të KPSHC-së të testit me shkrim të ankueses dhe se ankuesja nuk ka arritur me asnjë dëshmi që të konstatoj saktë shkeljen e pretenduar, rrjedhimisht nga kjo pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që në bazë të Formularit Form. MAP-SHCK-10 të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë janë vlerësuar me 418.5 të pikëve ndërsa ankuesja është renditur e dyta me 408.75 të pikëve, andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”**, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”** dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr. KZKA – 10/2019 të datës 29.07.2019, ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit N. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.2604/19 të datës 25.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.186/2021

Hysni MUSTAFA

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Gjyqtarës Lirije Maksutaj
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

